

Komuna Shtime

01/10/2024  
0211014

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E SHTIMES-OPSTINA SHITLJE
Nr i Prot./Br Prot. <u>02/273</u>
Nr i Faqeve/Br.strana _____
Data/Donal: <u>01-10-2024</u>
SHITIME/SHITLJE



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### Ndërmjet:

Komuna e Shtimes, me seli në Shtime, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Qemajl Aliu (në tekstin e mëtejme "Pranuese"),

dhe

"Medica", me seli në Obiliq, rr. Hasan Prishtina pn, përfaqësuar nga Ardian Ukelli (në tekstin e mëtejme "Dhuruese"), në vijim do të referohen bashkërisht si "Palët."

Duke marrë parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Komunës së Shtimes, veçanërisht në fushën e diagnostikimit dhe trajtimit të hershëm të kancerit të gjirit;

Duke njohur rëndësinë e parandalimit dhe diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve, dhe duke përkrahur të drejtën për shëndetësi të qasshme për të gjithë qytetarët;

Palët bien dakord për bashkëpunim në kuadër të dhurimit të pajisjes Mamograf Digjital të prodhuesit italian Geneal Medical Meratte - Giotto (GMM) që do të përdoret nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Komunën e Shtimes për qëllime të kontrollimit dhe detektimit të kancerit të gjirit.

## **Neni 1 – Objekti i Memorandumit**

1.1. Ky Memorandum ka për qëllim të rregullojë procedurat për dhurimin, respektivisht pranimin e pajisjes Mamograf Digjital nga Dhuruesja për Pranuesen.

1.2. Pajisja e dhuruar është e prodhuesit italian Geneal Medical Meratte - Giotto (GMM) dhe do të përdoret për kontrollimin dhe detektimin e kancerit të gjirit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare të Komunës së Shtimes.

## **Neni 2 – Detyrimet e Dhurueses**

2.1. Dhuruesja është përgjegjëse për:

- Sigurimin e pajisjes Mamograf Digjital sipas këtij Memorandumi.
- Liferimin, instalimin dhe lëshimin në punë të pajisjes.
- Trajnimin e stafit për përdorimin e pajisjes sipas instruksioneve të prodhuesit,

## **Neni 3 – Detyrimet e Pranueses**

3.1. Pranuesja merr përsipër:

- Pranimin e pajisjes Mamograf Digjital dhe vendosjen e saj në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami”
- Siguron hapësirën ku do të bëhet instalimi i pajisjes mjekësore.
- Kryerjen e kontrolleve të rregullta teknike dhe mirëmbajtjen e pajisjes për të siguruar funksionimin e saj të vazhdueshëm.
- Sigurimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme teknike dhe certifikatave përkatëse për përdorimin e pajisjes.

## **Neni 4 – Afatet dhe modalitetet e dhurimit**

4.1. Pajisja do të dorëzohet brenda një periudhe prej maksimumi 10 ditësh nga nënshkrimi i këtij Memorandumi.

4.2. Palët do të koordinojnë çdo hap të nevojshëm për dërgimin dhe pranimin e pajisjes.

## Neni 5 – Dispozita përfundimtare


5.1. Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet i vlefshëm deri në përfundimin e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në të.

5.2. Palët angazhohen të respektojnë dispozitat e këtij Memorandumi dhe të zgjidhin çdo mosmarrëveshje përmes dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.


Në dëshmi të marrëveshjes, Palët nënshkruajnë këtë Memorandum në dy kopje, secila me fuqi të barabartë ligjore.

Kryetari i Komunës

  
Qemajl Aliu



Përfaqësuesi i "Medica"

  
Ardian Ukelli

